



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM
Nr. 138, datë 22.10.2019

PËR REVOKIMIN E VENDIMIT NR. 137 DATË 21.09.2019 “PËR PEZULLIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT TË KANDIDATURAVE DHE NJOFTIMIN E SUBJEKTIT QË E KA VËNË NË LËVIZJE, PRESIDENTIN E TË REPUBLIKËS, PËR TË VLERËSUAR RISHPALLJEN E THIRRJES PËR PARAQITJEN E KANDIDATURAVE PËR PLOTËSIMIN E VENDIT VAKANT NË GJYKATËN KUSHTETUESE, VAKANCË E PARAKOHSHME, TË SHPALLUR ME DEKRETIN NR. 10723 DATË 07.02.2018 NGA PRESIDENTI I REPUBLIKËS”, SI EDHE VIJIMIN E PROCEDURAVE TË VERIFIKIMIT DHE TË VLERËSIMIT TË KANDIDATURAVE PËR PLOTËSIMIN E VENDIT VAKANT NË GJYKATËN KUSHTETUESE, VAKANCË E PARAKOHSHME, TË RISHPALLUR ME DEKRETIN NR. 11291 DATË 27.09.2019 NGA PRESIDENTI I REPUBLIKËS

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 125 dhe pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 7/b të ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të nenit 229 dhe pikës 1 të nenit 234 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, duke pasur parasysh se në datën 22.10.2019 është depozituar lista e kandidatëve që kanë shprehur interesin për kandidim në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të rishpallur me dekretin nr. 11291 datë 27.09.2019 nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

VENDOSI:

1. Revokimin e vendimit nr. 137 datë 22.10.2019 “Për pezullimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve dhe njoftimin e subjektit që e ka vënë në lëvizje, Presidentin e Republikës së Shqipërisë, për të vlerësuar rishpalljen e thirrjes për paraqitjen e kandidatëve për plotësimin e vendit vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, të shpallur me Dekretin nr. 10723 datë 07.02.2018 nga Presidenti i Republikës”.
2. Vijimin e procedurave të verifikimit dhe të vlerësimit të kandidatëve për plotësimin e vendit vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, të rishpallur me dekretin nr.11291 datë 27.09.2019 nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.



KRYETARI

Ardian Dvorani